

Renditja e pesë sureve të para të Kuranit

Es-Sujuti, *el-Itkaan*, 2/225

Në diskutimin e tij rreth lidhjes mes ajeteve dhe sureve (*munesabet*) në librin e tij të mirënjohur mbi shkencat kuranore, Imam Xhelal ed-Din es-Sujuti përfshiu edhe pasazhet në vijim, ku përmend lidhjet mes pesë sureve të para të Kuranit dhe disa nga temat kryesore që përmbajnë ato:

Disa dijetarë thanë:

- Sureja el-Fatiha përbëhet nga: 1) Konfirmimi se Allahu është Zoti; 2) Kërkimi i shpëtimit tek Ai me anë të fesë së Islamit; 3) Ruajtja nga feja çifute dhe ajo e krishtere.
- Sureja el-Bekare përmban bazat e kësaj feje.
- Sureja Aal-Imran përmbush synimin e sures el-Bekare. El-Bekare, në njëfarë mënyre, është një prezantim i provave për një vendim, ndërsa Aal-Imran është një përgjigje ndaj dyshimeve që hedh një dëgjues grindavec. Kjo është arsyeja përse Aal-Imran përmend shumë çështje të dyshimta për të cilat kapen të krishterët. Në këtë sure u bë i detyrueshëm edhe rituali i Haxhit (3:97), kurse në el-Bekare rituali i Haxhit përmendet vetëm si diçka e lejueshme. Pra, Ai urdhëroi njerëzit për ta kryer Haxhin në mënyrën e plotë pasi kishin filluar ta zbatonin.

Në suren Aal-Imran ishin të krishterët ata të cilëve u drejtohej më së shumti (Shpallja), ndërsa në suren el-Bekare më së shumti u drejtohej çifutëve. Kjo sepse Tivrati qe rrënja, ndërsa Inxhili qe një degë e asaj rrënje. Pasi pejgamberi ﷺ migroi në Medinë, ftoi çifutët në Islam e më pas edhe iu desh t'i luftonte, ndërsa kundërshtimi i të krishterëve erdhi më vonë, ashtu siç të ftuarit e idhujtarëve në Islam ndodhi më herët sesa të ftuarit e ithtarëve të Librit.

Kështu, ti gjen suret Mekase të përmendin fenë që kishin të gjithë pejgamberët dhe t'u drejtohen të gjithë njerëzve, ndërsa gjen suret Medinase t'u drejtohen besimtarëve dhe ithtarëve të Librit që u kanë besuar atyre pejgamberëve, si p.sh. "O ithtarë të Librit ...", "O bijtë e Israilit ...", "O ju që besoni ..."

- Për sa i përket sures en-Nisa, kjo përbëhet nga vendime për lidhjet mes njerëzve. Këto lidhje ndahen në dy kategori: 1) Lidhja që Allahu krijoi dhe 2) Lidhjet që rrjedhimisht u përcaktuan për njerëzit. Shembuj të kësaj janë lidhja e prejardhjes ose lidhjet e vendosura nga martesat. Në këtë frymë, kjo sure nis me thënien e Allahut ﷻ:

“O njerëz, kini frikë Zotin tuaj që ju krijoi të gjithë juve nga një njeri i vetëm dhe prej tij krijoi bashkëshorten e tij ...” (4:1)

Pastaj thotë:

“...kini frikë Allahun nëpërmjet të cilit kërkoni të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet familjare ...” (4:1)

Pra, ki parasysh këtë lidhje mahnitëse në fillim të sures dhe stilin artistik të hapjes së saj. Ky ajet hapës përfshin shumicën e vendimeve që gjenden në këtë sure. Përfshin, fjala vjen, çështjen se me cilën femër personi bën ose s'bën të martohet, trashëgimtarët që vijnë nga ana familjare (sipas lindjes), dhe faktin se origjina e tërë kësaj ndërmarrjeje ishte krijimi i Ademit عليه السلام e më pas i bashkëshortes së tij dhe, rrjedhimisht, edhe i një numri të madh burrash e grash që dolën nga ata dy.

- El-Ma'ideh është një sure marrëveshje, e cila përmban një shpjegim tërësor rreth vendimeve të ligjësuara, plotësim të fesë, përmbushje premtimesh nga ana e të Dërguarve dhe të zotimeve të popujve të mëhershëm. Kjo është një sure e përmbushjes dhe me të u plotësua feja (5:3). Kjo meqë surja përfshin në vete:

- Ndalimin e gjuetisë për ata që janë duke kryer ritualin e haxhit, gjë që plotëson gjendjen rituale të haxhiut.
- Ndalimin e pijeve dehëse, gjë që plotëson masat mbrojtëse të mendjes dhe të fesë së njeriut
- Masën ndëshkuese për kriminelë, si hajnat dhe banditët, gjë që plotëson masat mbrojtëse të gjakut dhe të pasurisë së njeriut
- Deklarimin e të gjitha ushqimeve të mira si të lejueshme, gjë që plotëson adhurimin e Allahut ﷻ

Kësodore sureja përmend çështje të caktuara, të cilat janë të veçanta për sheriatin (ligjin) e Muhamedit ﷺ, si: abdesi, tejemumi, dhe marrja e Kuranit për gjykatës në tërë fenë. Kjo është arsyeja që ti gjen shumë raste që tregojnë plotni dhe përmbushje përgjatë sures. Po ashtu përmendet se Allahu ﷻ do të zëvendësojë këdo që ia kthen shpinën fesë me të tjerë që do të jenë më të mirë (5:54) dhe kjo fe të vazhdojë në gjendjen e plotnisë. Në fakt, është përcjellë se kjo sure ishte gjëja e fundit që u shpall, për shkak të karakterit përmbyllës dhe plotësues të saj.

Pra, renditja e këtyre katër sureve Medinase paraqet një shembull të një renditjeje të përkryer. (*el-Itkaan fi Uluum el-Kur'an*, 2/226)

Shënim: Në pjesën më të hershme të kësaj kaptine, es-Sujuti sjell disa shembuj të lidhjeve mes fundeve të një sureje dhe fillimit të sures së radhës, përfshirë këtu dhe lidhjen mes fillimit të sures el-Bekare dhe fundit të sures el-Fatiha:

Një tjetër shembull është ai ku Allahu ﷻ hap suren el-Bekare duke thënë:

“*Elif. Lam. Mim.* Ky është Libri ...” (2:1-2),

gjë që përbën një referencë që të kthen mbrapa te Rrugë në thënien e Allahut ﷻ:

“Na udhëzo në Rrugën e Drejtë.” (1:6)

Kjo i bie sikur njerëzit të pyetnin për udhëzimin që çon në Rrugën e drejtë dhe t’u thuhej: “Rrugë për të cilën kërkuat të udhëzoheshit është ky Libër (Kurani).” Ky është një interpretim i saktë, që qartazi tregon lidhjen mes sures el-Bekare dhe sures el-Fatiha. (*el-Itkaan*, 2/225)